

Banka për Biznes ka kënaqësinë të mbështesë Kodin Financiar për Gratë Ndërmarrëse ("WE Finance Code" ose "Kodi"), një iniciativë ndërkombëtare që promovon barazinë gjinore duke forcuar më tej qasjen e grave ndërmarrëse në produkte dhe shërbime financiare.

Në kuadër të këtij angazhimi, BPB do të bëhet pjesë e koalicionit kombëtar dhe ndërkombëtar të udhëhequr nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, me synim avancimin e përfshirjes financiare dhe mbështetjes së grave në ndërmarrësi.

Si nënshkruese e Kodit "WE Finance", BPB zotohet për angazhim në secilën nga tre shtyllat e Kodit:

Zotimet për LiderShip:

1. BPB ka kënaqësinë të emërojë z. Bujar Statovci dhe znj. Rona Rushiti Begolli si kampionë të Kodit "WE Finance", të cilët do të përfaqësojnë BPB-në në kuadër të koalicionit kombëtar, do të koordinojnë zbatimin e brendshëm të Kodit dhe do të kontribuojnë në sigurimin e përputhshmërisë së politikave dhe praktikave të bankës me objektivat dhe parimet e këtij koalicioni.
2. BPB do të angazhohet në zbatimin e Kodit "WE Finance" përmes shfrytëzimit të kapaciteteve dhe burimeve ekzistuese të departamenteve të Burimeve Njerëzore, Marketingut dhe Biznesit. Në këtë kuadër, ambasadorët për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) në pronësi të grave do të integrohen në strukturat ekzistuese të biznesit në zyrën qendrore, në koordinim të ngushtë me degët rajonale, me synim ofrimin e mbështetjes së specializuar për bizneset e udhëhequra nga gratë, si dhe avancimin e qasjes në produkte financiare të përshtatura dhe shërbime këshilluese profesionale.
3. BPB mbetet e përkushtuar ndaj promovimit të një mjedisi pune të drejtë, gjithëpërfshirës dhe të balancuar. Politikat e Burimeve Njerëzore sigurojnë mundësi të barabarta në rekrutim, zhvillim dhe avancim profesional, duke mbështetur një përfaqësim të qëndrueshëm gjinor në të gjitha nivelet e bankës. Banka promovon balancën punë-jetë përmes benefiteve të avancuara, përfshirë vikendin e zgjatur (orarin e shkurtuar të ditës së premtë) dhe 12 muaj pushim të paguar të lehonisë. Parimet e barazisë gjinore, diversitetit dhe ndërgjegjësismit ndaj paragjytimeve të pavetëdijshme janë të integruara në Kodin e Mirësjelljes dhe në programet e detyrueshme të trajnimit për stafin. Gjithashtu, këshilltarët për klientët e bizneseve kanë përfunduar trajnimet relevante mbi mundësitë e ofruara nga Fondi i Garancisë Kreditore.
4. BPB angazhohet për transparencë dhe raportim të rregullt lidhur me iniciativat që mbështesin barazinë gjinore. Raporti Vjetor i bankës do të përfshijë një seksion të dedikuar mbi progresin në mbështetjen e NMVM-ve në pronësi të grave, përfaqësimin gjinor në staf dhe menaxhment, si dhe avancimin në zbatimin e Kodit "WE Finance". Përmes aktiviteteve të marketingut dhe kanaleve të komunikimit digjital, BPB do të vazhdojë të promovojë bizneset e drejtuara nga gratë dhe të ndajë histori suksesi që kontribuojnë në fuqizimin dhe rritjen e dukshmërisë së tyre ekonomike.

Zotimet për të Dhëna:

1. BPB do të harmonizojë sistemet e raportimit me përkufizimin e dakorduar për NMVM-të në pronësi të grave, duke e integruar atë në proceset e klasifikimit të klientëve dhe segmentimit të portofolit. Banka gjithashtu do të avancojë infrastrukturën e të dhënave për të mundësuar raportim më të detajuar dhe të ndarë sipas gjinisë në përputhje me kërkesat e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK).

2. BPB do të mbledhë dhe raportojë në mënyrë të strukturuar të dhënat mbi depozitat dhe kreditimin e NMVM-ve, të ndara sipas gjinisë, në përputhje me kërkesat e Bankës Qendrore të Kosovës. Banka do të avancojë sistemet e saj të të dhënave për të evidentuar arsyet e refuzimit të aplikimeve për kredi dhe për të mundësuar analizë më të detajuar të sfidave me të cilat përballen gratë ndërmarrëse. NMVM-të në pronësi dhe udhëheqje të grave do të kategorizohen veçmas në sistemet e menaxhimit të informacionit, duke mbështetur analiza më të sakta dhe zhvillimin e produkteve të përshtatura sipas nevojave të tyre.
3. BPB do të kontribuojë në promovimin e një qasjeje të unifikuar të raportimit në nivel industrie, përmes zbatimit të përkufizimit të koalicionit për NMVM-të e udhëhequra nga gratë. Raportimi do të sigurojë transparencë mbi strukturën dhe performancën e portofolit të këtyre bizneseve, duke mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të produkteve dhe shërbimeve financiare dhe jo-financiare.

Zotimi për Veprim:

1. Pas analizës së rezultateve të pyetësorit si dhe të dhënave të tregut nga dashboard-i, do të vlerësohet dhe sipas nevojës do të zbatohen përshtatjet përkatëse.
 - a) Ridizajnimin e produkteve ekzistuese të kreditimit, me qëllim përshtatjen më të mirë ndaj nevojave specifike të bizneseve të udhëhequra nga gratë;
 - b) Zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja financiare për NMVM-të në pronësi të grave, bazuar në analizën e të dhënave që ofron dashboard-i.
2. Në kuadër të Shërbimeve Jo-Financiare, BPB angazhohet të dizajnojë dhe zbatojë programe të dedikuara trajnimi dhe mentorimi përmes Akademive të Biznesit. Këto programe synojnë fuqizimin e kapaciteteve sipërmarrëse, rritjen e edukimit financiar dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të bizneseve dhe mentorimit të personalizuar.
3. BPB synon të rrisë përfaqësimin e NMVM-ve të udhëhequra nga gratë në bazën e saj të klientëve, si dhe të zgjerojë vëllimin e financimit të dedikuar për këtë segment. Banka do të inkurajojë klientet gra të përdorin një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh financiare—përfshirë kreditë, kursimet, llogaritë, garancitë dhe shërbimet digjitale—duke ofruar një qasje të integruar të mbështetjes financiare. Përmes fushatave të targetuara të marketingut dhe komunikimit, BPB do të promovojë NMVM-të në pronësi të grave si një segment strategjik, duke rritur ndërgjegjësimin për mundësitë në dispozicion, përfshirë edhe dritaren “Gratë në Biznes” të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK).